



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:127059

Datë: 27.02.2024

Numri i dokumentit: 05378772

**C.nr.1802/23**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm**, gjyqtari Shaban Shala, me bashkëpunëtorin profesionale V.D. duke vendosur në çështjen juridike të paditësit N.B. nga Mamusha, të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Mamushës – Drejtoria Komunale e Arsimit, lidhur më kompensimin e shujtave, më datë 27.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET në tërësi si e bazuar** kërkesë padia e paditësit, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Mamushës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqimin ditor-shujtën t'ia paguajë paditësit shumë prej 194,00 € (njëqind e nëntëdhjetë e katër euro), për vitin 2022 deri me datën 18.11.2022, duke llogaritur një ditë pune 2 € për 97 ditë pune, me kamatë ligjore prej 8 % nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë (06.06.2023) në afatin prej 7 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

**II. DETYROHET** e paditura që t'ia paguajë paditësit shpenzimet procedurale dhe atë në lartësi prej 124.00 € në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**A r s y e t i m**

Paditësi N.B. nga Mamusha, të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Mamushës – Drejtoria Komunale e Arsimit – DKA, lidhur më kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë punës.

E paditura duke vepruar sipas aktvendimit të gjykatës më dt. 31.10.2023 ka dorëzuar në gjykatë përgjigjen në padi me anë të së cilës e ka kundërshtuar në parim padinë dhe kërkesë padinë me arsyetimin se paditësja nuk i takon kompensimi i shujtave pasi që nuk është anëtarë i Sindikatës së Arsimit si dhe faktin se paditësja nuk i ka përfunduar të gjitha procedurat administrative për realizimin e kërkesës së tij. Po ashtu ka theksuar se Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Informacionit përmes njoftimit me nr.01B/488 të datës 21.11.2022, të dërguar Sindikatës ZBASHK ka bërë të ditur se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 20.01.2021 ka shkëputur Kontratës, andaj si e tillë kjo kontratë nuk është në fuqi dhe se nuk prodhon efekt juridik.

I autorizuari i paditësit me datë 25.10.2023, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, ku ka caktuar saktë ditët e punës për paditësin deri me datën 18.11.2022, ku paditësi ka gjithsej 97 ditë pune dhe për secilën ditë nga 2 euro, i takon kompensimi në shumë prej 194.00€.

Paditësi padisë ia ka bashkangjitur provat materiale si në vijim: kontratën e punës me nr. 2 të datës 01.09.2021, vërtetimin e datës 24.02.2023, me nr. prot. 30/23 dhe listën e pagave.

Nga provat e administruara më lartë nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura – Shkolla Fillore e Mesme e Ulët “Anadolu” në Mamushë, por mbetet kontestues fakti se paditësit a i takon kompensimi për ushqimin ditor për shujtat për të cilën çështje gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar për shkak se kjo kërkesë e paditësit është e rregulluar me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë 01/B nr.105 dt. 22.01.2021 konkretisht të nenit 35.7 i cili rregullon të drejtën për shujtë – ushqim ditor për ditët e kaluara në punë, në rastet kur punëdhënësi nuk e ka organizuar ushqimin në punë sikurse në rastin konkret.

Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjyqjese dhe gjendjen faktike të vërtetuar, se paditësi është aktualisht në marrëdhënie pune tek e paditura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesë padinë e paditësit, ashtu që e detyroi të paditurën që paditësit t’ia kompensojë ushqimin ditor në shumat më detalisht të vendosura sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke llogaritur një ditë pune nga 2 € për shkak se nga provat materiale konkretisht vërtetimet të lëshuara nga vet e paditura vërtetohet se paditësi ka aq ditë pune të përcaktuara gjithashtu detalisht sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale bazohet në nenit 449, 452 dhe 453.1 të LPK-së, ku është obliguar pala e paditur që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 124.00 €, dhe atë në emër të përpilimit të padisë 104.00 € dhe në emër të taksës për padi 20.00 € bazuar në tarifën e OAK-së.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 143 dhe 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**-Departamenti i përgjithshëm-**  
**C.nr.1802/23, me datë 27.02.2024**

**B. Profesionale**  
**Valmira Dakaj**

**Gjyqtari**  
**Shaban Sh. Shala**

**UDHËZIME PËR ANKESË:** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.